



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN

ИСНЕ
ИНСТИТУТ ЗА СТРАТЕШКИ ИСТРАЖУВАЊА И ЕДУКАЦИЈА
INSTITUTE FOR STRATEGIC RESEARCH AND EDUCATION



МАКЕДОНСКИ
ЦЕНТАР ЗА
МЕЃУНАРОДНА
СОРАБОТКА



SI TË PARANDALOHET KORRUPSIONI ZGJEDHOR MES STUDENTËVE?

Përmbledhje nr.9

Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Edukim

www.isie.org.mk

korrik 2024

Në këtë përmbledhje

paraqesim rekomandimet kryesore që dolën nga projekti, të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e realizimit të të drejtave të studentëve në lidhje me parandalimin e korrupsionit zgjedhor në mjedisin e tyre. Studimi është i disponueshëm në gjuhën maqedonase dhe shqipe në faqen tonë të internetit www.isie.org.mk.

Qëllimi jonë:

të ndërmerren veprime të menjëhershme, duke përfshirë edhe akcione me ndikim për nevojat dhe sfidat aktuale që lidhen me korrupsionin, veçanërisht në parandalimin e korrupsionit ndaj studentëve në periudhën parazgjedhore.



Për projektin

Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Edukim – IHSE Shkup në periudhën prej 01.04.-31.08.2024 realizon projektin „Aksioni për parandalimin e korrupsionit zgjedhor ndaj studentëve”. Projekti realizohet në kuadër të programit „Qytetarët kundër korrupsionit” (QKK) financuar nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës përmes Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID/Maqedonia e Veriut.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit, në periudhën para mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare, IHSA organizoi pesë punëtori gjysmë ditore kushtuar parandalimit të korrupsionit zgjedhor për studentët në pesë qendra universitare në vend (Manastir, Ohër, Tetovë, Shtip dhe Shkup) me gjithsej 137 pjesëmarrës si dhe dy tryeza të rrumbullakëta me palët kryesore të interesit në Shkup dhe Tetovë.

Në kuadër të projektit, është përgatitur edhe Raport për vlerësimin e gjendjes për rezistencën ndaj korrupsionit zgjedhor te popullata studentore me anketë me 218 të anketuar, si dhe Udhëzues për parandalimin e korrupsionit zgjedhor mes studentëve.

Këto publikime janë të disponueshme në faqen e internetit të IHSA - www.isie.org.mk.

KONKLUZIONE

Bazuar në hulumtimin e realizuar, u përcaktuan konkluzionet e mëposhtme:

- ⇒ Duke pasur parasysh numrin e madh të studentëve në nivel nacional, mungojnë masa dhe mekanizma të veçanta për mbrojtjen e studentëve nga ekspozimi ndaj korrupsionit zgjedhor.
- ⇒ As Kodi Zgjedhor dhe as në Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit (veçanërisht kapitulli i katërt) nuk janë përfshirë masa të veçanta për mbrojtjen e studentëve gjatë zgjedhjeve (edhe pse disa rregulla të veçanta të përgjithshme janë të përfshira të cilat kufizojnë ndikimin përmes pagesave të ndryshme nga periudha e zgjedhjeve.
- ⇒ Strategjia nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit 2021-2025 nuk përfshin masa të veçanta që synojnë parandalimin e korrupsionit zgjedhor që i drejtohen studentëve.
- ⇒ Në thelb, partitë politike në një pjesë të rëndësishme në programet e tyre i drejtohen studentëve duke parashikuar një sërë masash, të cilat një pjesë e madhe janë të karakterit financiar.
- ⇒ Të dhënat nga anketa treguan disa kushte të cilat mund të merren parasysh për përmirësimin e kushteve:
- ⇒ Sipas të anketuarve, burimi më i madh i korrupsionit të mundshëm zgjedhor është vendosja e studentëve në konviktet studentore, me c'rast vijnë ushqimet e subvencionuara të studentëve dhe bursat shtetërore të studentëve dhe
- ⇒ Edhe pse shumica e të anketuarve nuk dinë se ku të denoncojnë korrupsionin zgjedhor dhe nuk kanë besim se do të veprohet në mënyrë përkatëse, megjithatë përsëri do të vendosnin të denoncojnë korrupsionin zgjedhor.

REKOMANDIME

- ⇒ Përfshirja e masave, si në volum ashtu edhe në përmbajtje, ka të bëjë me parandalimin e ekspozimit të studentëve ndaj korrupsionit zgjedhor në strategjinë e ardhshme nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.
- ⇒ Precizimi i dispozitave ligjore në Kodin Zgjedhor dhe në Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit me masa dhe mekanizma për mbrojtjen e studentëve.
- ⇒ Vendosja e mekanizmave të kontrollit në konviktet e studentëve gjatë shpërndarjes së akomodimit të studentëve dhe shpërndarjes së ushqimeve studentore me karakter ad hoc gjatë viteve zgjedhore.
- ⇒ Zbatimi i aktiviteteve edukative në drejtim të njohjes së studentëve me mënyrat e denoncimit të korrupsionit zgjedhor dhe mekanizmat të cilat janë në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të studentëve.
- ⇒ Përforcimi i kapaciteteve në nivel të institucioneve të arsimit të lartë dhe formave të veprimit të organizuara nga studentët për mbrojtjen e studentëve nga ekspozimi ndaj korrupsionit zgjedhor

Dokumenti është përgatitur nga Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Edukim - IHSE me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe në partneritet me MCMS. Përmbajtja dhe mendimet e shprehura në këtë dokument janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e MCMS, USAID-it ose Qeverisë së SHBA-së.